VENDIM
Nr.356, datë 26.2.2020

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, PËR NDËRMARRJEN INDUSTRIALE NR.1 TIRANË, TË PASURISË NR.1/645, ZONA KADASTRALE NR.8210, TIRANË, DHE MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS SË SHITBLERJES SË PASURISË SË PALUAJTSHME NR.1/645/ND, ZONA KADASTRALE 8210, TIRANË, PËR QËLLIM TË ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË ZHVILLIMIT "POLI I DREJTËSISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 5, të vendimit nr.234, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për Programin e Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë"", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për Ndërmarrjen Industriale Nr.1 Tiranë, të pasurisë së paluajtshme "truall", me numër pasurie nr.1/645/ND, në zonën kadastrale 8210, Tiranë, për ta përdorur për qëllimin e mirëfunksionimit të godinës me numër pasurie nr.1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, ku do të zhvillojnë aktivitetin e tyre organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, në kuadër të zbatim të Programit të Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë".
2. Miratimin e projektkontratës së shitblerjes së godinës me numër pasurie nr.1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë autorizohet të nënshkruajë kontratën e shitblerjes së godinës së sipërpërmendur, pas verifikimit të përputhshmërisë së saj me legjislacionin në fuqi mbi shitblerjen e pasurive të paluajtshme.
3. Autorizohet Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë t'i kalojë me kontratë huapërdorjeje, pa kundërshpërblim, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës, mjediset e godinës me numër pasurie nr.1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi, pas kalimit të pronësisë, sipas të pikës 2, të këtij vendimi.
4. Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë kryen shërbimet e mirëmbajtjes së godinës dhe të truallit funksional. Shpenzimet e mirëmbajtjes mbulohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij vendimi. Për fillimin e aktivitetit, Ndërmarrjes Industriale Nr.1 Tiranë i akordohen 5 000 000 (pesë milionë) lekë në formën e transfertës, të cilat përballohen nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, programi "Menaxhimi i shpenzimeve publike", miratuar për vitin 2020.
5. Vlera financiare e shitblerjes së godinës, me numër pasurie nr.1/645/ND, zona kadastrale 8210, Tiranë, paguhet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 2, të projektkontratës. Për vitin 2020, kësti i pari i pagesës së godinës do të përballohet nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin "Projekte zhvillimi" dhe "100 Fshatrat" dhe do t'i transferohet Ndërmarrjes Nr.1, Tiranë.
6. Vendimi nr.670, datë 7.8.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Dhomën Kombëtare të Avokatisë, të pasurisë së paluajtshme, me sipërfaqe 25 000 (njëzet e pesë mijë) m^2, me nr.1/190,

në zonën kadastrale 8210, Tiranë, komponent i pronës nr.64, me emërtim "Ish-fusha e aviacionit", për ta përdorur për ndërtimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë", shfuqizohet.

7. Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe